



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 553, datë 12.11.2020**

**PËR**

**DETAJIMIN E POZICIONEVE AKTUALË TË NDIHMËSAVE LIGJORË NGA GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË PRANË GJYKATAVE TË APELIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “ë”, nenin 94 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe nr.495, datë 21.10.2020 “Për krijimin e “Njësisë së Shërbimit Ligjor” si pjesë e strukturës së gjykatave të apelit”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

**VENDOS:**

1. Detajimin e pozicioneve aktuale të ndihmësve ligjor nga gjykatat administrative të shkallës së parë pranë gjykatave të apelit, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë nga data 01.12.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA NR. 1**

Nr.	Gjykata	Ndhmës ligjorë
-----	---------	----------------

		<b>ishte</b>	<b>bëhet</b>
1	Gjykata e Apelit Durrës	1	3
2	Gjykata e Apelit Gjirokastrë	1	2
3	Gjykata e Apelit Korçë	1	2
4	Gjykata e Apelit Shkodër	1	2
5	Gjykata e Apelit Tiranë	6	14
6	Gjykata e Apelit Vlorë	1	3
7	Gjykata adm.shk.parë Durrës	2	0
8	Gjykata adm.shk.parë Gjirokastrë	1	0
9	Gjykata adm.shk.parë Korçë	1	0
10	Gjykata adm.shk.parë Shkodër	1	0
11	Gjykata adm.shk.parë Vlorë	2	0
12	Gjykata adm.shk.parë Tiranë	8	0

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**